



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 278/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) në Kamenicë, paraqitur kundër komisionierëve të vendotimeve, për shkak të parregullsisë gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 11.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit Lëvizja Vetëvendosje LVV në Kamenicë

Arsyetim

Me datën 09.06.2014, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Kamenicë, ka parashtruar ankesë në PZAP, ku thekson se më 08 qershor në Kamenicë në të gjitha vendvotimet afërsisht 10.59% e numrit total të votuesve kanë votuar me asistencë nga persona të tretë që kishin shoqëruar ata.

Parashtruesi i ankesës shton se këto veprime ngrihet dyshimi se këto vota janë të manipuluar dhe të drejtuara nga vullneti i personave asistues.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesës nuk qëndrojnë, sepse nga provat e ofruara në ankesë nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur një gjë e tillë dhe se në cilat QV apo VV kanë votuar me asistencë edhe pse LQP me nenin 89.5 parasheh se *Votuesi i cili është me aftësi të kufizuar në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedhë fletëvotimin dhe / ose është analfabet mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi nëse ai kërkon një ndihmë të tillë.* Me këtë rast PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithësuar dhe nuk mund të konstatohet një shkelje e tillë, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LQP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 278/2014 më datën 11.06.2014

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashtohet në Nenin 118.4 të LQP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

